



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH

Nr. ____ prot.

Belsh më: 18 .08.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-SHERBIM

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Shërbim për implementimin e programit(software) për taksat vendore”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): Shërbimet e zhvillimit të softwarve - 72262000-9

Vlera e fondit limit: 4 166 666(katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë e gjashtë)lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Komisioni i Specifikimeve Teknike ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

Argumentimi:Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, të ndryshuar dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, të ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik“, të ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se: Pika 1 Neni 83: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.” Pika 2 Neni 83: “Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës”, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LLP-së Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 41, të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e madhe se 40% e vlerësë përllogaritur të fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me nenin 77, pika 1/b dhe pika 3, e LPP-së Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, pasi është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të vendosi kërkesa të cilat garantojnë se operatorët ekonomik pjesëmarrës kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën si dhe në nenin 43 të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vjetët e fundit financiarë.” Gjithashtu në përputhje me nenin 55, pika 4, paragrafi 1 dhe 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.” Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023-2024-2025**, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, indryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE Vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilitetit të miratuar “ I ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridic që detyrohen për auditim ligjor të pasqyrave financiare detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspert kontabël ose shoqëri audituese:”c)shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite rradhazi, tejkalojnë dy prej treguesve të mëposhtëm:** i)totali I aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milion lekësh ; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milion lekësh ; iii)ja, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP si dhe nenit 43, pika 4, të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave Prokurimit publik” I ndryshuar. Përcaktimi I viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” I ndryshuar , Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006”Për tatimin mbi të ardhurat” I ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “ për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore Brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me ankeset e tij, si dhe cdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financës në zbatim të këtij ligji. Ndërsa shoqëimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c) të Ligjit nr.1009/2009: “Personat juridik që detyrohen për auditim ligjor të pasqyrave financiare detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspert kontabël ose shoqëri audituese:”c)shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite rradhazi, tejkalojnë dy prej treguesve të mëposhtëm: i)totali I aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milion lekësh ; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën.

2.2.1 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore këstet e maturuara të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026 sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar);prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit te QKB, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë, ” përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin ”.

Argumentimi: Në lidhje me Vërtetimin për likuidimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, kërkesa e mësipërme është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” të ndryshuar dhe në përputhje me nenin 76, pika 2 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar. Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2026, sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin

ligjor në fuqi, konkretisht me Ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” të ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari tregtare, kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatorie konomikduhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në një vlerë jo më të madhe se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.**

- a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, kontrata dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur sipas përcaktimeve bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar si dhe të nenit 40, pika 4 dhe nenit 55, pika 4/b., të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, pasi është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të vendosi kërkesat të cilat garantojnë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për ta zbatuar kontratën. Nga ana e Autoritetit Kontraktor janë kërkuar vërtetimin për realizimin e kontratave të ngjashme në përputhje me bazën ligjore të sipërpërmendur për të vërtetuar që ofertuesi/ofertuesit pjesëmarrës ka/kanë përvojën e duhur, ka/kanë kapacitetet e duhuara si teknike dhe organizative për të realizuar një kontratë të tillë. Paraqitja e vërtetimit për realizimin me sukses të kontratave të ngjashme nga ana e Operatorit Ekonomik dëshmon me korrëktësi në përmbushjen me sukses të detyrimeve kontraktore të Operatorit Ekonomik në raste të tjera të ngjashme si në cilësi ashtu dhe në afatet duke krijuar besueshmëri te Autoriteti Kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës. Në bazë të këtij kriteri operatorët ekonomik vërtetojnë eksperiencën në fushën objekt prokurimi dhe autoriteti kontraktor merr garancinë e nevojshme që shërbimi do të realizohet me sukses. Përvoja e operatorit ekonomik është një element shumë i nevojshëm për autoritetin kontraktor për të vërtetuar qëndrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmëria në përmbushjen e suksesshme të kontratës. Për kontratat e realizuara nga operatori ekonomik, operatori duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar me qëllim të shërbejë autoritetit në vlerësimin sa më të qartë të kriterit për eksperiencat e ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë një numër mesatar punonjësish jo më të vogël se 5 (pese)punonjes, të deklaruar për periudhën e fundit të deklaruar përpara datës së hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e fundit të deklaruar.
- b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore

Shënim: *Në procedurat e prokurimit me një fazë, ” përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin ”.*

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për punonjësit është vendosur sipas përcaktimeve të nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 4, gërma “c” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Kërkesa specifike për stafin e kërkuar është përcaktuar që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Për të përcaktuar numrin e punonjësve të nevojshme për realizimin e kontratës është bërë analize mbi afatin e realizimit të shërbimit, mbi llojin e shërbimit, mënyrën si do të realizohet, volumin e punës për kryerjen e këtij shërbimi, si dhe instensitetin e rëndësinë e jashtëzakonshme të sistemit, pasi mos realizimi me sukses i saj sjell dëme të konsiderueshme për institucion. Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky është një numër minimal i kërkuar për të vërtetuar kapacitetin e fuqisë punëtore që duhet për të bërë të mundur realizimin në kohë dhe me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat si më poshtë:

- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë SSH/DIN/EN/UNI/ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë ose ekuivalente.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë përcaktuar bazuar në pikën 1, të nenit 79, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit si dhe referuar nenit 44 pika 1., të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që

garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë, dhe mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusi i klientit, përshtatshmëria e burimeve të tij, kompetenca/ profesionalizmi i punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimi i cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimeve që ofron, garantimi i një procesi cilësor të furnizimit e shërbimit sigurimi i konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij. Përbushja e standardeve ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar aktmarrëveshjes.

- Çertifikatën e Sistemit të Menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit ISO/IEC 20000-1:2018 (e vlefshme), të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë ose ekuivalente.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 79 të LPP, nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të shërbimit. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Standardi ISO 20000-1:2018 (ose ekuivalent) përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohen në teknologjitë e informacionit. Përbushja e standardeve ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik të demonstroj aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht shërbime që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve, pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit.

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar aktmarrëveshjes)

- Çertifikatën e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit ISO/IEC 27001:2013 (e vlefshme), të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë ose ekuivalente.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 79 të LPP, nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar

nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ky standard specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Vlerësimi i rreziqeve të sigurisë së informacionit dhe veprimi ndaj këtyre rreziqeve (i ashtuquajtur “trajtimi i rreziqeve”) përmes kontrolleve të sigurisë së informacionit në pajtim me kërkesat e standardit përfaqësojnë një bazë të sigurt për të siguruar konfidencialitetin, disponueshmërinë dhe integritetin e informacionit përkatës dhe arritjen e objektivave të dëshiruara të sigurisë. Siguron një kornizë për zbatimin e politikave, procedurave dhe masave në proceset e menaxhimit të rrezikut të informacionit të organizatës. Nisur nga rëndësia e kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit Kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht shërbime që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve, pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra AK-së .

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën/certifikatat ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt marrëveshjes

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 1 (një) specialist në zhvillimin e aplikacioneve Back-End në teknologjinë .NET ose ekuivalente, me jo më pak se 3 (tre) vite me përvojë profesionale në zhvillimin e aplikacioneve Back-End.

Për këtë specialist duhet të paraqiten:

- CV;
- diploma ose certifikatë përkatëse;
- kontrata e punës ose dokument tjetër që provon marrëdhënien e punës;
- dëshmi që është i deklaruar në listëpagesë.

Shënim: Kjo pike konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të futesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. ...”.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 pika 4 , dhe neni 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Specialisti Back-End është profesionisti që merret me zhvillimin dhe administrimin e pjesës së aplikacionit që realizon logjikën e biznesit, përpunimin e të dhënave dhe komunikimin ndërmjet aplikacionit, bazës së të dhënave dhe komponentëve të tjerë të sistemit.Në rastin konkret, sistemi duhet të realizojë funksione të shumta, përfshirë administrimin e subjekteve tatimpaguese, familjeve, pasurive, detyrimeve, faturave, pagesave, debitorëve dhe raporteve, si dhe funksione për importimin dhe eksportimin e të dhënave dhe, kur është e aplikueshme, integrimin me sisteme të tjera.Ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me objektin, pasi sistemi i administrimit të taksave kërkon zhvillim, konfigurim, integrim dhe mirëmbajtje të komponentëve të aplikacionit që realizojnë logjikën e biznesit, përpunimin e të dhënave, autentikimin, autorizimin dhe komunikimin me bazën e të dhënave dhe komponentët e tjerë të sistemit.Kërkesa për minimumin prej 3 vitesh eksperiencë synon të garantojë që personi i angazhuar disponon përvojën praktike të nevojshme për realizimin e detyrave teknike të kontratës. Referenca ndaj

teknologjisë “.NET ose ekuivalente” nuk synon kufizimin e operatorëve ekonomikë vetëm në një teknologji të caktuar, por kërkon që specialisti të ketë kompetenca në teknologjinë e përdorur ose në një teknologji me karakteristika dhe funksionalitete të krahasueshme.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 1 (një) specialist në zhvillimin e ndërfaqeve të përdoruesit (Front-End), me eksperiencë jo më pak se 3 (tre) vite në React. ose teknologji ekuivalente.

Për këtë specialist duhet të paraqiten:

- CV;
- diploma ose certifikatë profesionale;
- kontrata e punës;
- deklarimi në listëpagesë.

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë, ” përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 pika 4 , dhe neni 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **Specialisti Front-End** është profesionisti që merret me zhvillimin dhe funksionimin e ndërfaqes nëpërmjet së cilës përdoruesit ndërveprojnë me aplikacionin dhe funksionalitetet e tij. Në rastin konkret, sistemi kërkohet të jetë i aksesueshëm nëpërmjet shfletuesve modernë dhe të përdorshëm nga kompjuterë, tableta dhe pajisje mobile. Gjithashtu, objekti përfshin një portal elektronik nëpërmjet të cilit subjektet/familjet duhet të kenë mundësi të aksesojnë informacionin lidhur me detyrimet, faturat, pagesat, pasuritë dhe njoftimet e tyre. Sistemi objekt i prokurimit do të përdoret nga punonjësit e Bashkisë dhe, sipas kërkesave të projektit, mund të përfshijë edhe ndërfaqe/portal për qytetarët dhe subjektet tatimpaguese. Për këtë arsye, nevojitet personel i specializuar në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e ndërfaqeve të përdoruesit, me qëllim garantimin e funksionalitetit, përdorshmërisë dhe përshtatshmërisë së sistemit me kërkesat e përdoruesve. Kërkesa për React.js ose teknologji ekuivalente ruan mundësinë e pjesëmarrjes së operatorëve që përdorin teknologji të tjera me funksionalitet të krahasueshëm. Kriteri synon të sigurojë që operatori ekonomik disponon burimin njerëzor të nevojshëm për realizimin dhe përshtatjen e ndërfaqeve të aplikacionit dhe portalit elektronik.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 1 (një) specialist për administrimin e bazave të të dhënave, me jo më pak se 3 (tre) vite eksperiencë profesionale.

Eksperienca mund të jetë në Oracle Database, Microsoft SQL Server, PostgreSQL, MySQL ose sisteme ekuivalente të administrimit të bazave të të dhënave.

Për këtë specialist duhet të paraqiten:

- CV;
- Diploma ose certifikatë profesionale;
- kontrata e punës;
- deklarimi në listëpagesë.

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë, ” përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 pika 4 , dhe neni 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Specialisti për administrimin e bazave të të dhënave është profesionisti përgjegjës për administrimin, mirëfunksionimin, sigurinë, performancën, ruajtjen dhe rikthimin e të dhënave të administruara në bazën e të dhënave. Në rastin konkret, baza e të dhënave do të përmbajë dhe përpunojë informacion lidhur me subjektet tatimpaguese, familjet, pasuritë, detyrimet, faturat, pagesat, debitorët dhe historikun e veprimeve. Specifikimet teknike kërkojnë gjithashtu funksione për:

- importimin e të dhënave nga Excel/CSV;
- kërkimin dhe filtrimin e të dhënave;
- gjenerimin e raporteve;
- ruajtjen e historikut të veprimeve;
- backup automatik;
- rikthimin e bazës së të dhënave.

Për këtë arsye, administrimi korrekt i bazës së të dhënave është një komponent thelbësor për funksionimin e sistemit dhe për ruajtjen e integritetit dhe disponueshmërisë së informacionit. Kërkesa për të paktën një specialist me jo më pak se 3 vite eksperiencë profesionale synon të sigurojë që operatori ekonomik disponon kapacitetin njerëzor të nevojshëm për administrimin e bazës së të dhënave gjatë implementimit dhe funksionimit të sistemit. Sistemi i administrimit të taksave do të mbështetet në një bazë të dhënash që do të përmbajë dhe përpunojë të dhëna të shumta financiare dhe administrative. Administrimi i saktë i bazës së të dhënave është i domosdoshëm për garantimin e integritetit, disponueshmërisë, performancës, sigurisë dhe rikuperimit të të dhënave. Për këtë arsye, kërkohet që operatori ekonomik të disponojë personel me kompetencat e nevojshme profesionale në administrimin e databazave. Pranimi i eksperiencës në Oracle Database, Microsoft SQL Server, PostgreSQL, MySQL ose sisteme ekuivalente garanton konkurrencën dhe nuk kufizon operatorët ekonomikë në përdorimin e një produkti të vetëm.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë ose të ketë marrëveshje bashkëpunimi me të paktën një specialist të sigurisë së informacionit, i cili do të angazhohet në implementimin e kërkesave të sigurisë së sistemit.

Për këtë specialist duhet të paraqiten:

- CV;
- diploma;
- kontrata e punës ose marrëveshja e bashkëpunimit.
- certifikuar me CISA, CISSP ose certifikim ekuivalent në fushën e sigurisë së informacionit.

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë, ” përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës

2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 pika 4, dhe neni 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Specialisti i sigurisë së informacionit është profesionisti që merret me identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit dhe me zbatimin e masave teknike dhe organizative për mbrojtjen e sistemit dhe të dhënave. Në rastin konkret, sistemi do të përpunojë të dhëna tatimore, financiare dhe administrative dhe do të ketë funksione për autentifikimin e përdoruesve, kontrollin e aksesit sipas roleve, administrimin e autorizimeve, regjistrimin e veprimeve në Audit Log, backup/restore dhe akses nëpërmjet portalit elektronik. Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë ose të ketë marrëveshje bashkëpunimi me një specialist të sigurisë së informacionit synon të sigurojë praninë e një kapaciteti profesional të dedikuar për zbatimin e kërkesave të sigurisë gjatë realizimit të kontratës. Specialisti do të angazhohet në implementimin dhe kontrollin e masave të sigurisë së sistemit, përfshirë kontrollin e aksesit, autentifikimin, autorizimin, mbrojtjen e të dhënave, evidentimin e incidenteve të sigurisë dhe masat e tjera të përcaktuara në specifikimet teknike. Kërkesa për certifikim profesional CISA, CISSP ose certifikim ekuivalent synon të sigurojë që specialisti disponon njohuri të dokumentuara profesionale në fushën e sigurisë së informacionit. Pranimi i certifikimeve ekuivalente synon të shmangë kufizimin e konkurrencës vetëm në mbajtësit e dy certifikimeve të përcaktuara.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë një menaxher projekti me jo më pak se 5 vite eksperiencë dhe certifikim PMP ose ekuivalent.

Për këtë specialist duhet të paraqiten:

- CV;
- diploma;
- kontrata e punës ose marrëveshja e bashkëpunimit

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë, ” përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 pika 4, dhe neni 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Menaxheri i projektit është profesionisti përgjegjës për planifikimin, koordinimin, monitorimin dhe kontrollin e realizimit të projektit, duke përfshirë koordinimin e burimeve njerëzore, afateve, detyrave dhe komponentëve të ndryshëm të projektit. Në rastin konkret, realizimi i sistemit për administrimin e taksave përfshin disa komponentë funksionalë dhe teknikë, si administrimi i subjekteve dhe pasurive, detyrimet dhe pagesat, raportimi, administrimi i përdoruesve, siguria, auditimi, backup/restore, portali elektronik dhe importimi i të dhënave. Për realizimin e këtyre komponentëve kërkohet koordinimi ndërmjet specialistëve të ndryshëm teknikë dhe ndjekja e fazave të implementimit deri në vënien në funksionim të sistemit. Kërkesa për certifikim PMP ose ekuivalent synon të garantojë njohuri të standardizuara në menaxhimin e projekteve. Kriteri duhet të jetë në përpjesëtim me kompleksitetin dhe vlerën e kontratës dhe eksperiencia e kërkuar duhet të përcaktohet në një nivel që lidhet me natyrën reale të projektit.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë angazhimi dhe një plan të mirëmbajtjes dhe asistencës teknike, me anë të së cilës angazhohet të ofrojë shërbimin e garancisë, mirëmbajtjes dhe asistencës teknike për një periudhë prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh nga marrja në dorëzim e sistemit, në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike dhe kontratës.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 pika 4, dhe neni 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Mirëmbajtja dhe asistenca teknike shërbejnë për të garantuar vazhdimësinë e funksionimit të sistemit pas implementimit dhe marrjes së tij në dorëzim, duke mundësuar korrigjimin e problematikave teknike, asistencën ndaj përdoruesve dhe ndërhyrjet e nevojshme për ruajtjen e funksionaliteteve të sistemit. Në rastin konkret, sistemi do të përdoret për administrimin e përditshëm të taksave dhe të ardhurave vendore dhe do të përpunojë të dhëna që lidhen me detyrimet, faturat, pagesat, debitorët dhe pasuritë, funksionimi i vazhdueshëm i sistemit është i rëndësishëm për veprimtarinë administrative të Bashkisë. Çdo problem teknik që nuk trajtohet në kohë mund të ndikojë në aksesin në të dhëna, administrimin e detyrimeve, proceset e pagesave dhe raportimin. Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë deklaratë angazhimi dhe plan mirëmbajtjeje dhe asistencë teknike për një periudhë 12-mujore nga marrja në dorëzim e sistemit lidhet drejtpërdrejt me nevojën e Autoritetit Kontraktor për të garantuar funksionimin e vazhdueshëm të sistemit. Duke qenë se programi do të përdoret për administrimin e taksave dhe të ardhurave vendore, ndërprerja ose mosfunksionimi i tij mund të ndikojë drejtpërdrejt në proceset administrative dhe financiare të Bashkisë. Për këtë arsye, gjatë periudhës së garancisë dhe mirëmbajtjes operatori ekonomik duhet të garantojë korrigjimin e defekteve, asistencën teknike, përditësimet e nevojshme, përditësimet e sigurtisë dhe përshtatjen e sistemit me kërkesat e përcaktuara në kontratë dhe specifikimet teknike. Kjo kërkesë lidhet me aftësinë teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik për të garantuar zbatimin e plotë të kontratës dhe vazhdimësinë e shërbimit.

II. Argumentimi specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga : Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit, kritereve të vecanta” mbështetur në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik” i ndryshuar, në varësi të objektit të kontratës përcjell me procesverbalin Nr.2896Prot., datë 12.08.2025 nga Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike krijuar me urdhërin Nr. 2372 Prot., datë 15.07.2026.

*Specifikimet teknike të hartuara për shërbimin objekt prokurimi, përshkruajnë elementet me të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar si dhe nenit 40 pika 2 e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, dhe çdo standard të kërkuar, referuar kërkesave dhe standardeve ndërkombëtare.***

NJËSIA E PROKURIMIT PUBLIK:

